



## PULSAR – KPRF & KPE

# ZBATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP-VE: MËSIMET E NXJERRA

Lívia Shinn Straková - Ekipi për SEKSP-të, EUROSTAT

*16 qershor 2021*

# Përmbajtja

- Qasja e SEKSP
- Udhëzues i SEKSP-së për zbatimin për herë të parë të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- Mësime e nxjerra nga reformat e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Shtetet Anëtare të BE-së (PwC 2014, 2018)
- Përditësim mbi pjekurinë e kontabilitetit në Shtetet Anëtare të BE-së



# Qasja e SEKSP-ve

- Një qasje më vullnetare dhe progresive:
  - Rritet transparencja fiskale në periudhën afatshkurtër deri afatmesme
  - Krahasueshmëri në periudhën afatmesme deri afatgjatë
- Faza 1: Rritja e transparencës në Shtetet Anëtare në periudhën afatshkurtër deri afatmesme përmes nxitjes së **kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara**, p.sh., SNKSP-ve, dhe paralelisht përgatitja e kuadrit të SEKSP-ve
- Faza 2: Trajtimi i krahasueshmërisë brendapërbrenda dhe midis Shteteve Anëtare në periudhën afatmesme deri afatgjatë.

# Udhëzues i SEKSP-së për zbatimin për herë të parë të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara (2017)

Udhëzuesi:

- synon t'i ndihmojë njësitë e sektorit publik në reformat e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara, si një hap drejt rritjes së transparencës fiskale dhe zbatimit të Standardeve Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SEKSP) të harmonizar në të ardhmen,
- i jep përparësi njohjes së aktiveve dhe pasiveve, duke mos përcaktuar matjen fillestare dhe të mëpasshme,
- këshillon mbi qasjet më të mira praktike për përzgjedhjen e aktiveve dhe pasiveve (p.sh., AAM – matja dhe zgjedhja) ose këshillon mbi dhënien e informacioneve shpjeguese, që duhet të jenë sa më të kufizuara, për të mos e mbingarkuar përdoruesin.

	SNKSP 33	Udhëzuesi FTI
<b>Objektivi</b>	Udhëzues i hollësishëm për zbatuesit për herë të parë gjatë periudhës kalimtare të futjes në zbatim të SNKSP-ve.	Udhëzues pragmatik për t'i ndihmuar njësitë e sektorit publik në hartimin e bilancit hapës me të drejta dhe detyrime të konstatuara apo për t'i përmirësuar pasqyrat me të drejta dhe detyrime të konstatuara pa u mbështetur në një paketë të plotë standardesh konkrete.
<b>Qasja</b>	Nga lart poshtë, me lehtësim nga disa kërkesa të caktuara të SNKSP-ve ("qasja e mospërfshirjes": përcaktohet çfarë të mos raportohet).	Nga poshtë lart, duke përcaktuar informacionet e raportuara ("qasja përfshirëse": përcaktohet çfarë të raportohet) duke rekomanduar përfshirjes ose mospërfshirje të zërave në bazë të një grupi kriteresh mbulimi dhe rekomandimesh pragmatike për matjen.
<b>Periudha kalimtare</b>	3 vjet	Kalim progresiv drejt bilancit të parë hapës të bazuar në SEKSP.
<b>Njohja</b>	Lehtësim nga SNKSP të veçanta për disa aktive dhe pasive të caktuara.	Rekomandime për njohjen minimale për herë të parë të aktiveve dhe pasiveve.
<b>Matja</b>	Lehtësim nga SNKSP të veçanta për disa aktive dhe pasive të caktuara, ku mund të përdoret kostoja e supozuar.	Hierarki e matjes, përfshirë qasjen e kostos së supozuar, duke iu referuar një grupi të veçantë aktivesh dhe pasivesh.
<b>Rregullimi i bilancit hapës</b>	Metoda retrospektive me përjashtime.	Rekomandohet metoda prospektive.
<b>Dhënia e informacioneve shpjeguese</b>	Fokusi te ndikimi që ka lehtësimi kalimtar nga SNKSP-të te pozicioni dhe performancë financiare, përfshirë rakordimin me bazën e mëparshme kontabël.	Fokusi te plotësia gjatë periudhës kalimtare, duke mbajtur parasysh natyrën pragmatike të qasjeve të ofruara për njohjen dhe matjen.
<b>Publikimi</b>	Pasqyrat financiare duhet të paraqiten të paktën një herë në vit (SNKSP 1).	Rekomandohet publikimi i pasqyrave financiare.

# Përshtatshmëria e SNKSP-ve në BE dhe ndikimet e mundshme të vënies në zbatim të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik

*Vlerësimi i SNKSP-ve dhe analiza e zbatimit të tyre në Shtetet Anëtare të BE-së (PwC, 2014)*

- ✓ Zbatimi i SNKSP-ve nga Shtetet Anëtare të BE-së
  - Transpozimi i SNKSP-ve në legjislacionin e brendshëm
  - Pjekuria e kontabilitetit sipas nivelit të qeverisjes, fushës kontabël
- ✓ Analiza e standardeve SNKSP
- 6 • Nevojat e Shteteve Anëtare dhe e palëve të tiera të interesit

*Mësime e nxjerra nga reformat e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Shtetet Anëtare të BE-së (PwC, 2018)*

- ✓ Objektivat, fushëveprimi dhe grupet e interesit
- ✓ Afatet dhe qasjet e vënies në zbatim
- ✓ Përfitimet e pritura dhe të arritura
- ✓ Vështirësitë e hasura më shpesh
- ✓ Rekomandimet për vënien në zbatim

# Vështirësitë e shpeshta (PwC, 2018)

- Vështirësitë e lidhura me menaxhimin e projekteve
  - Afatet e shtrënguara
  - Kompleksiteti dhe kostot e vënies në zbatim të sistemeve informatike
  - Trajnimi i nevojshëm
- Vështirësitë funksionale dhe teknike
  - Përshtatja e politikave, proceseve dhe sistemeve
  - Regjistrimi i aktiveve dhe pasiveve
  - Përdorimi i të dhënave me të drejta dhe detyrime të konstatuara për informim dhe vendimmarrje

# Praktikat e mira / rekomandime (PwC, 2018) I.

## Praktikat e mira të vënies në zbatim

- Dokumente udhërrëfyese të harmonizuara me objektivin e reformës
- Qeverisje e unifikuar/menaxhim i fortë i projekteve
- Dispozita ligjore të detyrueshme
- Udhëzues dhe asistencë efektive gjatë të gjithë vënies në zbatim
- Plane të formalizuara trajnimi

## Faktorët kryesorë të suksesit

- Përfshirja dhe mbështetja e palëve të nevojshme të interesit
- Afate të përshtatshme
- Integrimi informatik



# Praktikat e mira / rekomandime (PwC, 2018) II.


## Administrimi i kostove

- Faktorët përkatës shtytës të kostove
- Qasjet për mbajtjen nën kontroll të kostove
- Monitorimi i kostove gjatë vënies në zbatim
- Në afatgjatë, përfitimet janë më të mëdha se kostot

## Nxitja e përdorimit të të dhënave me të drejta dhe detyrime të konstatuara

- Ndhmon përdorimin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara – përdoruesit e brendshëm
- Palët e jashtme të interesit – kuptojnë dhe përdorin raportet financiare të bazuara në të drejta dhe detyrime të konstatuara
- Kapërcehet hendeku midis raportimit financiar me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe atij monetar


# Përditësim mbi pjekurinë e kontabilitetit – qeverisjet qendrore



Pjekuria mesatare e kontabilitetit (jo e ponderuar) është rritur nga 51% në 65%.

Burimi: PwC Survey 2019

- $AM \geq 70\%$
- $40\% \leq AM \leq 70\%$
- $AM \leq 40\%$



# Komunikimi

Komisioni Evropian – Eurostat – SEKSP:

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/>

- Udhëzues i SEKSP-së për zbatimin për herë të parë të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- Kostot dhe përfitimet e mundshme, duke përdorur SNKSP-të si tregues të tërthortë për SEKSP-të e ardhshme, në lidhje me vënien në zbatim të kontabilitetit të harmonizuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Shtetet Anëtare të BE-së: analiza mbi standardet SNKSP dhe zbatimin e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së (2014)
- Informacion i mëtejshëm dhe i përditësuar në lidhje me vënien në zbatim të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik (2018)

Qëndroni të informuar – ndiqni mediat sociale:



[@EU\\_Eurostat](https://twitter.com/EU_Eurostat)



[@EurostatStatistics](https://www.facebook.com/EurostatStatistics)



[@EU\\_Eurostat](https://www.instagram.com/EU_Eurostat)

# Faleminderit



Nëse nuk thuhet ndryshe, ripërdorimi i këtij prezantimi lejohet sipas lejes CC BY 4.0 .